



Legjislatura X
Sesioni V

SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 21 dhjetor 2023, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrorit nr. 70, datë 19.12.2023 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 14.12.2023.
(Neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime.
(Neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)
3. **Shqyrtimi i kërkesës nr.prot. 3822, datë 12.12.2023, “Për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë së deputetit z. Sali Berisha, nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit”.**
(Në mbështetje të neneve 73, të Kushtetutës, dhe neneve 13 dhe 118 të Rregullores, shumicë e thjeshtë)
4. **Projektligj “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Unionin për Konservimin e Natyrës (IUCN)”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare)
Koha e votimit

5. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për hartat treguese të rrjetit transevropian të transportit në Shqipëri”.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

6. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2020, për projektin “Programi i performancës dhe investimeve në sektorin e ujërave, pjesa e dytë, (infrastruktura 2 komunale, faza V, pjesa II)””.** *(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

7. **Projektligj “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.**

(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, dhe nenet 55, 73-74, 78-84 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane

Dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit nen për nen dhe në tërësi

8. **Projekligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8891/2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”.**

(Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të

Drejtat e Njeriut

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

9. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta)